



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1103/1 Prot.

Tiranë, më 18.04 2023

**VENDIM**

Nr. 25 dt. 18.04 2023

**MIRATIMIN E PËRJASHTIMIT NGA TARIFA PËR KURSIN E CERTIFIKIMIT TË ROJEVE BREGDETARE, TË STUDENTËVE TË UST, PËR VITIN KALENDARIK 2023**

Në zbatim të, nenit 49, të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës Vendimit nr.36, datë 05.04.2023 të Rektoratit “Për miratimin e përjashtimit nga tarifa për kursin e certifikimit të Rojeve Bregdetare, të studentëve të UST, për vitin kalendarik 2023”, në Vendimin e Senati Akademik Nr.47 datë 07.04.2023 “Për miratimin e përjashtimit nga tarifa për kursin e certifikimit të rojeve bregdetare, të studentëve të UST, për vitin kalendarik 2023” Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 18.04.2023,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e përjashtimit nga tarifa për kursin e certifikimit të “Rojeve Bregdetare”, të studentëve të UST, drejtuar nga Departamenti i Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizmit, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, për vitin kalendarik 2023.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqe [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek trasparenca universitare.

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

Artur COBANI

